

**RREGULLORE E PUNËS SË KËSHILLIT AKADEMIK TË KOLEGJIT  
RIINVEST**

**Prishtinë**

**19 mars 2018**

**BPrAL Kolegji Riinvest sh.a.**  
**KËSHILLI AKADEMIK**

Në bazë të dispozitave të nenit 16 të Statutit të BPrAL Kolegji Riinvest (në tekstin e mëtejme Kolegji), Këshilli Akademik i Kolegjit, i grumbulluar në mbledhjen e mbajtur më 19 mars 2018 në selinë e Kolegjit në Prishtinë, ka miratuar këtë:

**RREGULLORE TË PUNËS SË KËSHILLIT AKADEMIK TË BPrAL KOLEGJI RIINVEST**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Me këtë Rregullore përcaktohen procedurat për thirrjen, udhëheqjen, mënyrën e vendosjes dhe çështjet e tjera organizative të mbledhjeve të Këshillit Akademik.

**Neni 2**  
**Përbërja dhe mandati i Këshillit Akademik**

1. Këshilli Akademik përbëhet nga Rektori i Kolegjit, i cili është edhe Kryetar i Këshillit Akademik, dhe përfaqësues tjerë të zgjedhur apo të emëruar në bazë të pozitive udhëheqëse në strukturat akademike të Kolegjit. Anëtarë të Këshillit Akademik të Kolegjit janë Udhëheqësit e Programeve Akademike të Kolegjit, përfaqësuesit e zgjedhur nga komitetet programore ku zgjidhen automatikisht mësimdhënësit e rregullt, nga tre përfaqësues të mësimdhënësve jo të rregullt, 2 përfaqësues të zgjedhur të administratës dhe 5 përfaqësues të zgjedhur të studentëve.
2. Mandati i anëtarëve të Këshillit Akademik është tri vjet dhe fillon ditën e parë të vitit akademik.
3. Këshilli Akademik do të veprojë në pajtim me ligjin, Statutin e Kolegjit, aktet tjera normative të Kolegjit dhe në bazë të dispozitave të kësaj Rregulloreje.

**Neni 3**  
**Përgjegjësitë e Këshillit Akademik**

1. Këshilli Akademik ka përgjegjësi për të vendosur për çështjet strategjike që lidhen me procesin e mësimdhënies dhe të studimeve, dhe me kërkimet shkencore.
2. Këshilli Akademik do të jetë përgjegjës që:
  - Të miratojë programet e studimeve të njësive akademike;
  - Të përcaktojë kriteret për regjistrimin e studentëve të rinj;
  - Të definojë standardet akademike për ligjërata dhe për sigurimin e cilësisë së studimeve;
  - Të përcaktojë kriteret për emërimin e personelit akademik;

- Të vendosë mbi strukturën dhe përmbajtjen e programeve mësimore;
  - Të përcaktojë përmbajtjen e të gjitha të dhënave akademike dhe dokumentacionit të kolegjit;
  - Të vendosë mbi zgjedhjet, avancimet dhe dhënien e titujve akademikë;
  - Të analizojë performancën e stafit akademik;
  - Të koordinojë mekanizmat për cilësinë e studimeve në Kolegj;
  - Të hartojë Strategjinë e zhvillimit dhe mbrojtjes së pronës intelektuale të Kolegjit.
3. Gjatë secilit vit akademik, Këshilli Akademik do të shqyrtojë:
- Zhvillimin akademik si dhe modifikimin e programeve të studimeve,
  - Raportet e komiteteve programore,
  - Suksesin e studentëve,
  - Raportin e Zyrës/Komisionit për sigurim të cilësisë,
  - Rregulloret e zbatueshme, dhe
  - Çështje tjera akademike.

#### **Neni 4**

##### **Kuorumi, mbledhjet dhe vendimmarrja në Këshillin Akademik**

1. Mbledhjet e Këshillit Akademik i fton Rektori/ja e Kolegjit, në bazë të kërkesës për konvokim të parashtruar nga Kryetari i Këshillit Akademik apo së paku një e katërta e anëtarëve të Këshillit Akademik. Mbledhje të Këshillit Akademik do të mbahen së paku dy herë gjatë një semestri akademik. Mbledhjet e Këshillit Akademik konvokohen me dërgimin e ftesës tek të gjithë anëtarët e tij, jo më vonë se dy ditë para mbajtjes së saj
2. Punimet e Këshillit Akademik i udhëheq Kryetari i Këshillit. Në mungesë të Kryetarit, punimet e Këshillit Akademik mund t'i udhëheqë një anëtar tjetër i autorizuar nga Kryetari me shkrim, apo anëtari më i vjetër i Këshillit Akademik i pranishëm në mbledhje.
3. Këshilli Akademik vendimet e veta i merr me shumicë votash në të gjitha mbledhjet e Këshillit Akademik në të cilat të pranishëm janë së paku gjysma e anëtarëve të tij, e të cilat janë konvokuar në mënyrë të rregullt dhe në pajtim me ligjet e zbatueshme, Statutin e Kolegjit dhe këtë Rregullore të Punës. Në rast se një propozim merr vota të barabarta për dhe kundër, vota e Kryetarit të Këshillit Akademik do të konsiderohet përcaktuese.
4. Çdo herë kur takohet Këshilli Akademik, duhet të mbahet procesverbal për çështjet që diskutohen me identifikim të pikave të përshtatshme veprimi për komente. Pas takimit, duhet t'u shpërndahet draft procesverbali të pranishmeve për komente në saktësi dhe pasi të nënshkruhet nga Kryetari, veprimet duhet të pasohen me rezultate që raportohen në takimin e radhës. Një kopje e procesverbaleve të tilla me pika veprimi duhet të mbahet në dosje për qëllim auditimi.

## Neni 5

### Komisionet dhe trupat punuese të Këshillit Akademik

1. Këshilli Akademik i ka 3 komisione të përhershme – Komisionin për Sigurim të Cilësisë, Komisionin Disiplinor, Komisionin për Ankesa. Këshilli mund të formojë edhe komisione e trupa tjerë, të cilët i ndihmojnë në realizimin e detyrave të veta. Në rast të krijimit të komisioneve dhe trupave të tilla Këshilli Akademik është përgjegjës për t'ua caktuar fushëveprimin, mandatin dhe kohëzgjatjen. Në rast se për komisionet dhe trupat punuese të Këshillit Akademik nuk miratohet rregullore e posaçme që rregullon funksionimin e tyre, dispozitat e kësaj rregulloreje në kuptim të konvokimit, punimeve dhe votimit do të vlejnjë me analogji.

2.1 Komisioni për Sigurim të Cilësisë është përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e procedurave të vlerësimit në pajtim me Statutin dhe rregulloret e Kolegjit. Komisioni siguron zbatimin e standardeve ndërkombëtare dhe standardeve të Agjencisë për Akreditim të Kosovës si dhe i propozon Këshillit Akademik rekomandime përkatëse. Komisioni i miraton afatet për vlerësim, e miraton përbërjen e ekipeve të vlerësimit dhe nxit kulturën e cilësisë.

2.2 Në fillim të çdo viti akademik, Komisioni për Sigurim të Cilësisë në takimin e parë zgjedh Kryesuesin e komisionit. Kryesuesi i komisionit zgjidhet me shumicë votash të anëtarëve të komisionit. Detyra e Kryesuesit të komisionit është që të organizojë punën e komisionit.

2.3 Komisioni për Sigurim të Cilësisë gjithsej ka tetë anëtarë: pesë anëtarë të zgjedhur - tre anëtarë të personelit mësimdhënës, një përfaqësues të studentëve dhe një përfaqësues nga administrata; dhe tre anëtarë të emëruar sipas detyrës zyrtare: Rektori, Sekretari i Kolegjit dhe Udhëheqësi i Zyrës për Sigurim të Cilësisë.

3.1 Komisioni Disiplinor formohet nga Këshilli Akademik për t'i shqyrtuar rastet e sjella para këtij komisioni nga ana e studentëve, stafit dhe menaxhmentit të Kolegjit. Komisioni ka pesë anëtarë të përhershëm të emëruar nga Këshilli Akademik, nga të cilët tre janë përfaqësues të personelit mësimor, një përfaqësues i studentëve dhe një përfaqësues i stafit administrativ.

3.2 Anëtarët e Komisionit Disiplinor duhet të përmbahen nga pjesëmarrja në shqyrtimet e këtij komisioni në rastet kur:

- (a) Personi mbikëqyrës apo vartës i tyre është subjekt i shqyrtimit në Komision Disiplinor;
- (b) Kur me personat, rasti i të cilëve është në shqyrtim kanë lidhje familjare apo miqësore; dhe/ose
- (c) Ka ndonjë konfliktit interesi, siç është specifikuar në Kodin e Mirësjelljes apo aktet tjera normative të Kolegjit.

3.3 Rregullat dhe procedurat e punës së Komisionit Disiplinor janë të detajuara në Kodin e Mirësjelljes të Kolegjit dhe në akte tjera normative të Kolegjit. Të njëjtat do të bëhen publike për të gjithë studentët, punonjësit dhe palët tjera me interes për Kolegjin.

4.1 Komisioni për Ankesa shërben si shkallë e dytë për shqyrtim të ankesave ndaj vendimeve të marra nga Komisioni Disiplinor.

4.2 Këshilli Akademik emëron pesë anëtarët e Komisionit për Ankesa, nga të cilët tre janë përfaqësues të stafit mësimor, një është përfaqësues i studentëve dhe një është përfaqësues i administratës.

4.3 Anëtarët e Komisionit për Ankesa duhet të përmbahen nga pjesëmarrja në shqyrtimet e këtij komisioni në rastet kur:

- (a) Personi mbikëqyrës apo vartës i tyre është subjekt i shqyrtimit para Komisionit për Ankesa;
- (b) Kur me personat, rasti i të cilëve është në shqyrtim kanë lidhje familjare apo miqësore; dhe/ose
- (c) Ka ndonjë konfliktit interes, siç është specifikuar në Kodin e Mirësjelljes apo aktet tjera normative të Kolegjit.

4.4 Rregullat dhe procedurat e punës së Komisionit të Ankesave janë të detajuara në Kodin e Mirësjelljes të Kolegjit dhe në akte tjera normative të Kolegjit. Të njëjtat do të bëhen publike për të gjithë studentët, punonjësit dhe palët tjera me interes për Kolegjin.

## **Neni 6**

### **Punimet e Këshillit Akademik**

1. Anëtarët e Këshillit Akademik të Kolegjit për mbledhjet e tij njoftohen përmes ftesave elektronike, të cilat dërgohen së paku dy ditë para mbajtjes së mbledhjes. Anëtarët e Këshillit Akademik duhet ta konfirmojnë pranimin e ftesës dhe pjesëmarrjen në mbledhje gojarisht apo me shkrim.

2. Rendi i ditës për mbledhjet e Këshillit Akademik dhe ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja paraprake e tij, krahas të gjitha dokumenteve të cilat do të shqyrtohen në mbledhjen e konvokuar, duhet t'u dërgohen të gjithë anëtarëve të Këshillit Akademik së paku një ditë para mbledhjes së tij.

3. Të gjithë anëtarët e Këshillit Akademik kanë të drejtë të kërkojnë përfshirjen e ndonjë pike relevante në rendin e ditës për mbledhjen vijuese, deri në gjashtë orë para kohës së paraparë për mbajtjen e mbledhjes së tij. Kjo kërkesë duhet t'i parashtrohet me shkrim Kryetarit të Këshillit Akademik apo Sekretarit të Kolegjit, në formë fizike apo elektronike.

4. Në mbledhjet e Këshillit Akademik, për secilën pikë të rendit të ditës çdo anëtar ka të drejtë të diskutojë vetëm njëherë dhe atë jo më gjatë se 5 (pesë) minuta. Replika lejohet vetëm nëse emri i anëtarit është apostrofuar dhe mund të zgjatë jo më shumë se 2 (dy) minuta. Kryesuesi

i mbledhjes mund të lejojë përjashtim nga kjo dispozitë, në rast se atë e konsideron të dobishme për mbarëvajtjen e punës së Këshillit Akademik.

5. Anëtarët e Këshillit Akademik duhet t'u përmbahen kodit të etikës dhe sjelljes profesionale përgjatë tërë veprimtarisë së tyre, në pajtim me dispozitat e ligjeve të zbatueshme dhe Statutit të Kolegjit. Në rast të mosrespektimit dhe mospërfilljes së këtij neni, Kryetari i Këshillit Akademik, ose Kryesuesi i mbledhjes ka të drejtë që anëtarit t'ia marrë fjalën dhe/ose kërkojë largimin e tij të përkohshëm nga punimet e tij.

## **Neni 7** **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore e Punës së Këshillit Akademik të Kolegjit hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga Këshilli Akademik dhe nënshkrimin nga Kryetari i Këshillit Akademik.

---

Bardha Qirezi  
Rektore  
Kryetare e Këshillit Akademik  
Kolegji Riinvest